



Shkurt 2025

Buletini

Fuqizimi i grave dhe zhvillimi i sektorit të gështenjës në Kosovë

Ndërmarrja rurale Freskia, një kompani në pronësi dhe e udhëhequr nga Shkurte Rustemi, po bëhet lidere e ndryshimeve në sektorin e gështenjës në Kosovë me mbështetjen e projektit Shfrytëzimi i Qëndrueshëm i Resurseve Natyrore për Mjedis dhe Zhvillim Ekonomik (SUNREED) të Fondacionit Lidhim Njerëzit me Vlerat e Natyrës (CNVP).

E vendosur në një rajon me pyje të gështenjave në Kosovën perëndimore, Freskia është e specializuar në mbledhjen, kultivimin, përpunimin dhe shitjen e produkteve pyjore jo-drurorë (PPJD), me fokus në praktikën e qëndrueshme si dhe në mbështetjen e komuniteteve vendore.

E përkrahur nga CNVP, Freskia zhvilloi një plan biznesi gjithëpërfshirës dhe në tetor 2024, filloi një iniciativë për të krijuar një pikë të shumëkërkuar grumbullimi të gështenjave përmes një investimi në komunën e Gjakovës.

Ky objekt i ri është një nxitje e drejtpërdrejtë e procesit të vjeljes së gështenjës duke përmirësuar ruajtjen dhe cilësinë e produkteve dhe duke zgjeruar çasjen në treg për komunitetin lokal, fermerët dhe pronarët e pyjeve private (PPP). Freskia ka arritur gjithashtu të nënshkruajë kontratat e para me nën-grumbulluesit për të menaxhuar procesin e grumbullimit dhe për të forcuar zinxhirin e vlerës së gështenjës.



Nurije Bajrami, mbështetet në pyllin e saj privat për të mbajtur familjen e saj prej shtatë anëtarësh.

Një faktor kyç në këtë iniciativë ka qenë bashkëpunimi i ngushtë në mes Shkurte-s, pronares së Freskia-s dhe Nurije Bajramit, një pronare e ve e një pylli privat. Nurija, e cila humbi burrin e saj gjatë luftës në Kosovë, tani e mban familjen e saj shtatë anëtarësh. përmes


pyllit të gështenjave që zotëron.

Të dy grate së bashku kanë zbatuar praktika të qëndrueshme sipas planit të menaxhimit, duke përfshirë edhe rralimin e 3 hektarëve të pyllit të Nurijes për të përmirësuar produktivitetin dhe qëndrueshmërinë e tij.

Ky trajtim silvikulturor ka përmirësuar pyllin e gështenjave, ka rritur prodhimin (rendimentin) e pyllit duke gjeneruar biomasë (mbetje pyjore), e cila i është shitur furnizuesit kryesor të sistemeve të ngrohjes me copëza druri (ashkla) në Gjakovë, duke kontribuar në prodhimin e energjisë së rinovueshme.

Ndikimi i kësaj nisme të udhëhequr nga gratë është i shumëanshëm, duke dhënë rezultate pozitive në disa nivele. Ajo forcon sektorin e gështenjës në Kosovë, nxit rritjen ekonomike vendore, përmirëson praktikën pyjore, promovon përdorimin e biomasës së drurit (mbetjet e pyjeve) për energji të qëndrueshme dhe fuqizon gratë, duke përforcuar rolet e tyre në menaxhimin e pyjeve dhe zhvillimin ekonomik rural.

Përfitimet e kësaj nisme janë edhe më të gjëra dhe shtrihen në gjithë komunitetin. Të paktën 30 familje në rajon pritet të kenë të ardhura të rritura duke shitur më shumë gështenja me çmime më të larta në një treg të qëndrueshëm të siguar nga pika e re e grumbullimit.



Mbledhja dhe përzgjedhja e gështenjave në pikën e grumbullimit të gështenjës Freskia.



Pyjet për energji të gjelbër

Një transformim i heshtur por me shumë ndikim po ndodhë në rajonin e pyllëzuar të Kamenicës. Këtu, pylli shërben si një burim i energjisë së gjelbër, duke fuqizuar shtëpitë dhe duke reduktuar emitimet e karbonit.

Me mbështetjen e projektit SUNREED të CNVP-së, kompania e prodhimit të ashklave të drurit dhe peletit Feniks-a ka bashkëpunuar me pronarin e pyjeve private Xhemajl Berisha, i cili zotëron 4.2 hektarë pyje, për të promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe për të kontribuar në zgjidhjet që bazohen në energjinë e gjelbërt.

E udhëhequr nga një plan menaxhimi i përgatitur me kujdes, ndërhyrja në pyllin privat të Berishës ishte projektuar për të ngritur vitalitetin dhe rritjen e pyllit duke kontribuar në tranzicionin e Kosovës drejt energjisë së rinovueshme. Procesi filloi me shënjimimin e pemëve për rrallim, i cili më pas rezultoi me rrallimin e 4.2 hektarëve pyll dhe në prodhimin e 200 tonëve biomasë.

Kjo biomasë u transportua në pikën e grumbullimit të themeluar nga Feniks-a në Gjakovë, ku u përpunua në ashkla druri. Këto ashkla tani furnizojnë ngrohoren e Gjakovës, duke siguruar ngrohje për afërsisht 30% të familjeve dhe apartamenteve të këtij qyteti gjatë muajve të ftohtë të dimrit.

I frymëzuar nga suksesi në Kamenicë, Feniks-a vazhdoi ta zgjerojë këtë model me tjerë fermerë dhe pronarë privatë të pyjeve duke rritur përdorimin e biomasës (mbetjet e pyjeve) për ngrohje qendrore dhe duke promovuar menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve në mbarë Kosovën.

CNVP, përmes projektit të saj SUNREED, mbështet përsëritjen (replikimin) e kësaj nisme për të siguruar që pyjet private të funksionojnë sipas planeve të menaxhimit duke arritur praktika të qëndrueshme pyjore në mbarë Kosovën.

Nga molla e egër tek uthulla cilësore

Biznesi i shquar vendor, Bio Alta, i udhëhequr nga pronarja Kadrija Mustafa, është më shumë se thjesht një fermë - është një shembull i



vërtetë i shpirtit të komunitetit, i drejtuar nga një grua sipërmarrëse. I vendosur në mes maleve dhe luginave të komunës së Kamenicës, biznesi është i specializuar në kultivimin dhe përpunimin e mollëve të egra.

Që nga fillimi i sezonit të vjeljes së mollëve në mes të gushtit, Kadrija dhe familja e saj kanë mbledhur më shumë se 5 tonë mollë të egra nga gratë e pesë fshatrave përreth Kamenicës. Deri më tani, Bio Alta e ka prodhuar uthullën e mollës me metoda tradicionale, por pajisjet e reja që kanë marrë e kanë çuar prodhimin e tyre në një nivel tjetër.

Në mars të këtij viti (2024), Bio Alta mori pajisje të reja për të përmirësuar përpunimin e mollëve të egra. Falë këtij investimi, Kadrija parashikoi të prodhonte mbi 4,000 litra uthull molle premium brenda një sezoni - një objektiv që e arriti së fundmi.



Falë cilësisë së lartë dhe vëllimit tashmë të shtuar të uthullës, Kadrija dhe familja e saj kanë zgjeruar rrjetin e tyre të shitjeve në mbarë Kosovën, duke arritur shitje tashmë në Fushë Kosovë, Vushtrri, Ferizaj, Gjiilan dhe Kamenicë. Gjithashtu, shitjet e tyre në internet

vazhdojnë të mbeten të forta dhe të qëndrueshme.

Me këtë ndihmë, BioAlta po ecën drejt krijimit të një ndikimi në Kamenicë dhe rajonin lindor të Kosovës, duke fuqizuar komunitetin dhe duke krijuar mundësi ekonomike për gratë në këtë komunë të rajonit lindor të Kosovës.

Zgjerimi i prodhimit të ushqimit vendor dhe tregjeve

Afërdita Murati, forca shtytëse e kompanisë së saj, Kastrioti, ka arritur një moment të rëndësishëm në rrugëtimin e kompanisë së saj, falë partneritetit me CNVP Kosova.

Kastrioti, i themeluar në vitin 2015, është i specializuar në kultivimin dhe prodhimin e lëngjeve dhe reçelrave nga frutat e pyllit si aronia, boronica dhe mjedra. Me një kapacitet prodhimi prej 3,000 litrash në vit, Kastrioti është i përkushtuar prej kohësh në mbështetjen e komunitetit vendor.

“Unë jam gjithmonë në kërkim të produkteve, mundësive dhe tregjeve të reja për biznesin tim. CNVP na ka ndihmuar të bëhemi më inovativ dhe modernizojmë prodhimin tonë”, tha Afërdita pasi morri pajisjet e reja.

Falë mbështetjes së projektit Përdorimi i Qëndrueshëm i Resurseve Natyrore për Mjedis dhe Zhvillim Ekonomik (SUNREED) të CNVP-së, i financuar nga Ambasada Suedeze në Prishtinë (Sida), Kastrioti ka siguruar pajisje të reja, duke përfshirë një mbushës lëngjesh, ndarësin e farave dhe një rezervuar për pasterizim.



Pajisjet e reja për përpunimin e frutave.

Ky hap do t'i mundësojë kompanisë të diversifikojë gamën e saj të produkteve, duke shtuar lëngje, shurape, reçelra dhe çajra të prodhuara nga boronica e kuqe, kulumri dhe kumbulla. Kastrioti synon të dyfishojë prodhimin e tij, duke arritur në 7,000 litra në vit.

Zgjerimi do të krijojë gjithashtu mundësi të reja për fermerët lokal, veçanërisht për gratë dhe grupet e marginalizuara, me synimin për të rritur numrin e grumbulluesve me 20-30% dhe për të kontribuar në fuqizimin e tyre ekonomik.



Përgatitja e lëngut të aronisë për shpërndarje në treg.

Për më tepër, Kastrioti planifikon të zgjerojë shtrirjen e saj në tregun e shitjes me pakicë duke bashkëpunuar me supermarkete dhe barnatore të mëdha anembanë Kosovës.

Ky moment i rëndësishëm përfaqëson jo vetëm rritjen e biznesit për Kastriotin, por gjithashtu një përkushtim për të forcuar kompaninë edhe komunitetin.